



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.316/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS) me shenjen ZL.Anr.316/2017 e datës 21.10.2017 e parashtruar kundër subjektit politik PDK me seli në Prishtinë, dega në Malishevë, me të cilën ka kërkuar që t'ju shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 21.10.2017 nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ku në ankesën ZL.Anr.316/2017 ka pretenduar se me datë 21.10.2017 kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal të Malishevës, Bekim Hoti nga radhët e PDK-së, ka shpërndarë një video të Fatmir Limajt të Fatmir Limaj të shoqëruar me mbishkrimin “SKANDAL: Fatmir Limaj fyen qytetarët e Malishevës”. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 36 par.1 pika b) e LZP.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur dy fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 22.10.2017, subjekti politik PDK thekson se pretendimet e BIRN janë të pa baza për arsye se shpërndarja e një shkrimi të pasqyruar dhe në video të portalit të MalishevaPRES.com e cila ka qenë e përhapur në faqen e këtij portali me datë 19.10.2017 ora 10:16 nuk përbën shkelje, pasi që në rastin konkret personi në fjalë nuk ka shpikur dhe nuk ka shpifur asgjë kundër Fatmir Limajt dhe se në këtë rast ai me asnjë deklaram të tij, nuk e komenton postimin e bërë nga portali në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesave BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore nga ana e subjektit politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga fotografrit që gjende në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet koha dhe data e shpërndarjes së videos.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.316/2017 më datën 22.10.2017



Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.